



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.4, datë 5.2.2007

**PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË APARATIT
TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç”, ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, Urdhërit Nr.7942, datë 18.9.2006 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale për shërbimet publike dhe funksionimi i komisioneve përkatëse”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.38, datë 17.7.2006 “Mbi një riorganizim të Njësisë së Planit Rregullues”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë disa ndryshime në strukturën organizative të aparatit të Bashkisë, sipas Pasqyrës Nr.1 bashkëlidhur.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative e Bashkisë së Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur.
3. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.38, date 17.7.2006 ndryshon si vijon:

Numri maksimal i punonjësve të Aparatit të Bashkisë së Tiranës është si vijon:

- Punonjës funksionar dhe nëpunës civil	364
- Punonjës me kontratë	70

4. Efektet financiare të këtij Vendimi të përballohen nga buxheti I bashkisë së Tiranës.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI